

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MAGUS TIRANA “

Sot me date 02.10.2023, shoqeria e-LAVA shpk, shoqeri e te drejtes shqiptare, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit, themeluar me date 05.05.2023, NIPT M31711031H, me seli ne Njesia Bashkiake nr.10, Rruga e Kavajes, Godina nr.123 - Tirane, mbeshtetur ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregetare”, ka vendosur te krijojte shoqerine tregetare me pergjegjesi te kufizuar te quajtur “MAGUS TIRANA” shpk me aktin e themelimit si vijon:

FORMIMI I SHOQERISE

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare e quajtur **“MAGUS TIRANA” sh.p.k.**

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqerise tregtare “MAGUS TIRANA” shpk do te jete ne: Tirane Farke, Lunder, Rruga “Rezervat e Shtetit” nr.1, Zona Kadastrale Nr. 2529, Nr. i Pasurisë 590/1/4, Volumi 6, Faqe 106.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

NENI 3

Shoqeria do te kete objekt veprimtarie:

- restorant, bar, delivery;
- import – eksport dhe tregtimin e produkteve ushqimore me shumice e pakice;
- organizim eventesh.

Shoqeria, me qellim investimin e kapitaleve te saj, mund te kete interesa dhe te marre pjese ne shoqeri te tjera qe kane objekte veprimtarie te cfaredo lloj natyre, te ngjashme, apo qe lidhen me aktivitetin e saj; ajo mund te jape gjithashtu garanci te pergjithshme, apo edhe reale per pale te treta.

Te gjitha aktivitetet e mesiperme duhet te kryhen brenda limiteve ose ne perputhje me normat qe rregullojne aktivitetin.

NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj Shoqeria mund te hape zyra te tjera, njesi perpunimi, sherbimi tregetimi dhe te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pacaktuar.

KAPITALI SHOQERISE, KONTRIBUTET DHE KUOTAT

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise tregtare **“MAGUS TIRANA” shpk** do te jete i barabarte me Leke 200.000(dyqind mije) dhe do te perbehet nga kuotat e ortakut themelues te shoqerise.

Kapitali themeltar eshte i perbere nga 1(nje) kuote, me vlere nominale prej 200.000 (dyqind mije) leke.

shoqeria e-LAVA shpk, shoqeri e te drejtes shqiptare, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit, themeluar me date 05.05.2023, NIPT M31711031H, ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 200.000 (dyqind mije) leke.

Sipas kontributit te siperpermendur shoqerise e-LAVA shpk, i perket 1 (nje) kuote, qe i korrespondon 100% (njqind per qind) te kuotave te kapitalit te Shoqerise.

NENI 7

Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te transferohen sipas parashikimeve ne Statut dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

ORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 8

Organi vendimmarres i Shoqerise eshte Ortaku Themelues.

NENI 9

Ortaku Themelues ka te drejte te emeruje nje apo me shume administratore, te cilet jane perfaqesuesit ligjore te shoqerise ne menyre kolegjiale. Ata mund te nderrmarrin te gjitha veprimet e zakonshme dhe te jashtezakonshme te administrimit, por gjithmone brenda kufijve qe u jep atyre Statuti i shoqerise.

NENI 10

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar.



NENI 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregetare”.

NENI 12

Akti i themelimit, u perpilua ne 2(dy) kopje, per t’iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare “MAGUS TIRANA” sh.p.k.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

Per shoqerine e-LAVA shpk

MARIN SHPATA

